



**ODA E AVOKATËVE TË KOSOVËS
ADVOKATSKA KOMORA KOSOVA
KOSOVA BAR ASSOCIATION**

Bazuar në nenin 41 par. 5 të Ligjit për Avokatinë lidhur me nenin 83 par.2 dhe nenin 104 të Statutit të OAK, Këshilli Drejtues i Odës së Avokatëve të Kosovës në seancën e mbajtur më 28 Dhjetor 2013 nxjerr:

RREGULLORE PËR DEGËT REGJIONALE TË OAK

I.DISPOZITAT E PERGJTHSHME:

Neni 1.

Degët Regjionale të avokateve janë forma të organizimit dhe aktivitetit territorial të Odës së Avokatëve të Kosovës, të cilat nën kushtet e përcaktuara me ligj janë të rregulluara me Statutin e OAK.

Neni 2.

Degët regjionale të OAK janë në; Prishtinë, Mitrovicë, Pejë, Gjakovë, Prizren, Gjilan dhe Ferizaj.

Neni 3.

1.Me këtë Rregullore, në pajtim me Statutin e OAK, përcaktohen:

- 1) Organizimi, detyrat dhe aktivitetet e Degëve Regjionale të Odës së Avokatëve të Kosovës (në tekstin e mëtejme: Degët Regjionale),
- 2) Anëtarësia e Degëve regjionale,
- 3) Organet e Degëve mënyrat e zgjedhjes dhe kompetencat,
- 4) Format e bashkëpunimit të avokatëve në nivelin e Degëve Regjionale, dhe
- 5) Çështjet të tjera të rëndësishme për organizimin dhe aktivitetet e Degëve Regjionale.

II.AKTIVITETET DHE FUSHËVEPRIMI:

Neni 4.

1. Degët Regjionale angazhohen që të:

- 1) Mbrojnë të drejtat dhe interesat e avokatëve dhe praktikantëve në regjionin e vet,
- 2) Zhvillojnë dhe përparojnë etikën profesionale dhe ngrisin vetëdijen e anëtarëve të vet për respektimin e standardeve etike,
- 3) Ruajnë pavarësinë dhe autoritetin e avokatit dhe përparojnë avokatinë në pjesën e regjionit për të cilin është themeluar,
- 4) Zhvillojnë aktivitete për ngritjen e përhershme profesionale të avokatëve dhe praktikantëve,
- 5) Shqyrtojnë problematikën lidhur me ushtrimin e profesionit të avokatisë në regjionin e vet,
- 6) Bashkëpunojnë me Degët tjera Regjionale, Gjykatat dhe organet tjera shtetërore dhe autoriteteve

të tjera ne territorin për te cilin janë themeluar,

7) Debatojnë, marrin qëndrimin e iniciativa dhe bëjnë propozimet për të gjitha çështjet nga fushëveprimi i OAK dhe organet e saj,

8) Të shqyrtojnë dukuritë e rëndësishme në përparimin dhe mbrojtjen e të drejtave te qytetareve dhe personave juridike në regjionin për te cilin janë formuar.

9) Si dhe aktivitete të tjera sipas kërkesave të Odes.

Neni 5

Këshilli Drejtues i OAK mbikëqyrë ligjshmërinë e punës dhe të aktivitetit të Degëve Regjionale dhe te organeve te tyre.

III.ANËTARËSIA

Neni 6

Anëtarë te Degëve Regjionale janë të gjithë avokatet të cilët selinë e zyrave e kanë në territorin e Degës përkatëse.

Neni 7

Te gjithë anëtarët e Degës janë të detyruar qe te marrin pjese ne aktivitetet e saj, të pranojnë punët dhe detyrat që u caktohen dhe të mbajnë përgjegjësin për zbatimin e tyre.

Neni 8

Anëtarët e Degëve Regjionale janë të obliguar që në punën dhe aktivitetin e vet të udhëhiqen nga principet e përcaktuara me Ligjin për Avokatinë, Statutin e OAK, Kodin e Etikes, këtë Rregullore si dhe aktet e tjera dhe vendimet e organeve të Odes.

Neni 9

Kryesia e Degës Regjionale jep mendim lidhur me plotësimin e kushteve të kandidatit për regjistrim ne regjistrin e avokatëve respektivisht të praktikanteve në territorin e të cilit është selia e zyrës së avokatit respektivisht zyra e avokatit tek i cili regjistrohet praktikanti.

Neni 10

Nëse, pas regjistrimit konstatohet se avokati respektivisht praktikanti nuk ka plotësuar kushtet për regjistrim, Dega regjional qe ka ardhë në dijeni për rrethanat e tilla duhet të iniciojë procedurën për fshirjen e emrit nga regjistri i avokateve përkatësisht praktikantit në Këshillin Drejtues.

Neni 11

Organet e Odes do ta njoftojnë Kryesinë e Degës regjionale për çfarëdo fillimi të procedurës disiplinore ndaj avokatit –anëtar i asaj dege.

Neni 12

Avokati të cilit i është shqiptuar masa e ndalimit të ushtrimit të avokatisë në kohë të caktuar ose i është ndalur e drejta e ushtrimit te avokatisë, nuk mund te merr pjesë në aktivitetet e Degës dhe në punën e organeve të saj.

Neni 13

Me rastin e ndërprerjes së veprimtarisë ose në rast të çfarëdo çregjistrimi, avokati pushon që të jetë anëtarë i Degës regjionale.

IV.ORGANET E DEGËVE REGJIONALE

Neni 14

Organet e Degës janë:

1. Kuvendi
2. Kryetari
3. Kryesia

Neni 15

Mandati i anëtarëve të organeve të Degëve zgjate 2 (dy) vite, me të drejte të rizgjedhjes edhe për një mandat.

1) Kuvendi i Degës

Neni 16

1. Është organi më i lartë i Degës regjional.
2. Kuvendin e Degat Regjionale e përbejnë të gjithë avokatet e regjistruar ne regjistrin e OAK, te cilët selinë e zyrës se vet e kanë në territorin e Degës përkatëse.

Neni 17

Përveç kompetencave të përcaktuara me Statutin e OAK, Kuvendi ka edhe këto kompetenca:

- 1) zgjedh dhe shkarkon Kryesine e Degës regjionale,
- 2) emëron dhe shkarkon delegatët për Kuvendin e OAK-së dhe përfaqësuesit në organet e tjera te OAK te cilët i ka emëruar, nëse vërtetohet se nuk e ka kryer detyrën ne mënyrë te denje dhe profesionale.
- 3) shqyrton të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me kryerjen e veprimtarisë së avokatisë dhe pozitën e avokatëve në territorin e vet,
- 4) shqyrton Raportin e punës dhe aktivitetin e Kryesisë se Degës,
- 6) përcakton propozimet dhe jep sugjerimet ne aktet normative të Odes
- 7) debaton, merr qëndrime e iniciativa dhe bene propozime në të gjitha çështjet nga fushëveprimi i vet,
- 8) shqyrton dhe vendos edhe për çështje të tjera të përcaktuara me aktet normative te OAK.

Neni 18

1. Kuvendi i Degës aktivitetin e zhvillon përmes Mbledhjes së Rregullt Vjetore.
2. Mbledhja e Rregullt Vjetore mblidhet një herë në vit dhe atë e thërret Kryesia e Degës.

Neni 19

1. Kuvendi mund të mblidhet gjithashtu edhe në Mbledhjen e jashtëzakonshme, me kërkesën e se paku 2 anëtarëve te Kryesisë, 1/3 të anëtareve të Degës ose Këshillit Drejtues.
2. Për mbajtjen e mbledhjeve të Kuvendit marrjen e vendimeve është e nevojshme që të marrin pjese shumica e anëtareve te Degës.
3. Për thirrjen, punën dhe vendimmarrjen në kuvend aplikohet përshtatshmerisht Statuti dhe Rregullorja për punën e Kuvendit të OAK.

Neni 20

1. Këshilli Drejtues i OAK do ta thirrë mbledhjen e jashtëzakonshme të Kuvendit:
 - 1) në rastet kur i Dega vepron në kundërshtim me interesat e OAK,

- 2) nëse marrëdhëniet ndërnjerzore në Degën regjional janë çrregulluar në atë masë sa rrezikojnë aktivitetin dhe funksionimin e Degës,
 - 3) në rastet e mosfunksionimit dhe mosaktivitetit,
 - 4) në rast të cenimit të ligjshmërisë së punës.
2. Në rastet kur vepron sipas par.1 të këtij neni Këshilli Drejtues mund të marrë mbi vete udhëheqjen e Degës deri në eliminimin e pengesave të cilat kanë shkaktuar marrjen e drejtimit.

Neni 21

Procesverbalet nga mbledhjet e Kuvendit dhe të gjitha vendimet e marra duhet, pa shtyrje t'i dërgohen Këshillit Drejtues të OAK.

2)Kryesia e Degës:

Neni 22

1. Kryesia e Degës regjional përbëhet nga kryetari, nënkryetari dhe sekretari.
2. Me rastin e propozimit të kandidatëve për Kryesinë e Degës, duhet të merret parasysh, por nuk do të kufizohet vetëm, në kriteret:
 - 1) që kandidati të jetë shquar me angazhimin dhe punën e vet,
 - 2) të jete entuziast dhe i përkushtuar,
 - 3) ta ketë besimin e anëtarëve të Degës Regjionale
 - 4) kandidati për kryetar të siguroj pëlqimin me nënshkrimin e 1/4 e anëtarëve të Degës
 - 5) që nuk ka pasur masë të plotfuqishme disiplinore gjatë 3(tri)viteve të fundit

Neni 23

Kryesia e Degës:

- 1) zbaton vendimet e Kuvendit dhe organizon aktivitetin e gjithmbarshëm të Degës,
- 2) zbaton vendimet, qëndrimet dhe programet e organeve të OAK,
- 3) zbaton programet dhe rekomandimet për ngritjen profesionale të avokatëve dhe praktikantëve,
- 4) jep rekomandime dhe propozime të interesit të përgjithshëm për ushtrimin e avokatisë në regjionin e vet,
- 5) udhëheq afarizmin financiar të Degës dhe vendos për shumën e të hollave me të cilat mund të disponojë Kryetari
- 6) shqyrton punën dhe aktivitetin e Kryetarit të Degës,
- 7) kryen aktivitete shoqërimi dhe bashkëpunimi me Degët e tjera regjionale,
- 8) kryen pune të tjera me rëndësi të përgjithshme të Odes të përcaktuar me aktet normative dhe vendimet e organeve të Odes,

Neni 24

Kryesinë e Degës regjionale e udhëheq Kryetari i Degës, i cili thërret dhe drejton mbledhjet dhe aktivitetin e saj. Në mungesë të Kryetarit mbledhjet e Kryesisë i udhëheq nënkryetari i saj.

Neni 25.

Kryesia vendos me shumicën e votave të anëtarëve. Secili anëtarë i Kryesisë duhet të abstenojë nga votimi për marrjen e vendimeve ose për çfarëdo çështje tjetër për të cilën e lidhe ose mund të dyshohet për lidhjen me interesin personal.

Neni 26

Kryetari i Degës ose dy anëtarë të Kryesisë mund të thërrasin mbledhjen e jashtëzakonshme të Kryesisë.

Neni 27

Thirrjet për mbledhjet e Kryesisë, se bashku me propozimin e rendit të ditës, u dorëzohen anëtarëve, me se voni 3 dite para mbledhjes.

Neni 28

Kryesia e Degës mund të vendose që t'i drejtohet për vendim Kuvendit të Degës për çfarëdo çështje nga kompetencat e tij.

Neni 29

Kryesia e Degës është e detyruar që të parqet raportet vjetore para kuvendit të Degës regjionale ose kurdoherë që kërkohet nga Mbledhja e Jashtëzakonshme e Kuvendit.

3) Kryetari i Degës regjionale

Neni 30

Kryetari i Degës:

- 1) përfaqëson dhe prezanton Degën,
- 2) përfaqëson Degën regjional në Këshillin Drejtues,
- 3) thërret dhe drejton mbledhjet e Kryesisë dhe udhëheq aktivitetin e saj,
- 4) lejon pagesat nga Arka e Degat deri në limitin e caktuar nga Kryesia dhe vendos për shpenzimin e tyre,
- 5) kujdeset për ligjshmërinë e punës së Degës,
- 6) i përcjell Këshillit Drejtues të OAK me kërkesën e saj, raportet për aktivitetin dhe punën e Degës regjional,
- 7) kryen punë të tjera të përcaktuara me këtë rregullore dhe vendimet e organeve të OAK

Neni 31

Kryetarin do ta zëvendësojë nënkryetari në rastet kur ai nuk mund ta ushtrojë detyrën si dhe sipas autorizimit të tij.

V.SIGURIMI I KUSHTEVE PËR PUNEN DHE AKTIVITETIN E DEGËVE REGJIONALE:

Neni 32

1. Këshilli Drejtues i OAK përcakton buxhetin vjetor për punën dhe aktivitetin e Degëve Regjionale.
2. Përveç buxhetit nga par.1 i këtij neni Këshilli Drejtues mund të sigurojë buxhet shtesë për degët Regjionale pas aprovimit të aktiviteteve shtesë të paraqitura nga degët në Këshillin Drejtues.

VII.AFARIZMI FINANCIAR:

Neni 33

Afarizmi financiar i degëve regjionale zhvillohet sipas paralogarisë vjetore mbi mjetet të cilat i ka lejuar Këshilli Drejtues dhe të dalat, të cilat i miraton Kuvendi i Degës.

Neni 34

Dega i përdorë mjetet financiare për realizimin e aktiviteteve të veta të përcaktuara me Statut dhe këtë Rregullore.

Neni 35

Bilancin mbi afarizmin financiar e miraton Kuvendi i Degës, në bazë të raportit të paraqitur nga ana e Këshillit mbikëqyrës. Viti financiar i Degës regjionale duhet të përputhet me vitin kalendarik.

VIII. SHENJA DHE VULA E DEGËS REGJIONAL

Neni 36

Dega regjionale e avokatëve duhet të ketë vulën e rrumbullakët, vulën katrore me mbishkrimin “Republika e Kosovës/Republika Kosova “Oda e Avokateve të Kosovës – Dega Regjionale _____”, vula katrore përmban edhe shenjen e protokollit. Nr. _____ dhe Dt. _____.

IX. PERSONELI I DEGËS

Neni 37

Degët Regjionale mund të kenë personelin e vet, i cili do të kryejë punë tekniko-administrative

Neni 38

Lidhur me kushtet për pranim, vendet dhe detyrat e punës, përgjegjësitë, pagën dhe çështjet e tjera lidhur me personelin e degëve regjionale do të zbatohen dispozitat e Statutit të OAK që kanë të bëjnë me administratën e Odes.

X. DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE:

Neni 39

Organet e Degëve, të zgjedhura sipas dispozitave që kanë qenë në fuqi para aprovimit të kësaj Rregulloreje, e vazhdojnë punën gjër në skadimin e mandatit.

Neni 40

Rregullorja hyn në fuqi ditën e aprovimit nga Këshilli Drejtues i Odës së Avokatëve të Kosovës dhe zbatohet nga data 01 Janar 2014.

**Av. Ibrahim Z. Dobruna,
Kryetar i OAK-së**